

**Titulli i kursit (lëndës mësimore): Hyrje në letërsi frankofone**

**Niveli dhe lloji i kursit:** Bachelor / Me zgjedhje

**Viti i studimeve dhe semestri:** III / 6

**Numri i orëve në javë:** 2+0

**Kodi ose shifra e lëndës:** - -

**Vlera në kredi ECTS :** 5

**Koha/lokacioni:** Ligj.- E enjte / 14<sup>30</sup>-16 / salla 14

**Mësimdhënësi i kursit:** Prof.Asoc.Dr. Avdi VISOKA,  
zyra 18 / e-mail: avdi.visoka@uni-pr.edu  
termini i caktuar për konsultime me studentë: E mërkure 13-14

**Qëllimet e kursit (modulit):**

*Ky kurs ka për synim formimin e studentëve në fushën e letërsisë frankofone, do të thotë të të gjitha atyre letërsive që e përdorin frëngjishten si gjuhë shkrimi për ta shprehur kulturën dhe qytetërimin e tyre specifik, të ndryshëm nga ai i Francës.*

*Do të studiohet historia e letërsisë frankofone dhe shtrirja e saj gjeografike në tërë botën.*

*Mandej do të studiohen letërsitë e veçanta frankofone (belge, zvicerano romane, kebekase, subsahariane, magrebiane, e lindjes së afërt dhe e Evropës lindore), autorët e veprat më të rëndësishme dhe tematikat dominuese të kësaj letërsie.*

*Do të preken edhe çështjet themelore të frankofonisë.*

*Studentët në këtë kurs do:*

- të njohin problematiken dhe rëndësinë e frankofonisë;
- të familjarizohen me orientimet kryesore të qytetërimit dhe letërsisë frankofone;
- të thellohen në studimin e letërsive të veçanta frankofone, autorëve e veprave më të rëndësishme dhe tematikave dominuese të kësaj letërsie

**Rezultatet e pritura të nxënies :**

*Pas përfundimit të kursit, studenti duhet të jetë në gjendje që:*

- t'i njohë letërsitë, autorët, veprat dhe tematikat kryesore frankofone;
- t'i dallojë dhe t'i krahasojë karakteristikat kryesore të teksteve dhe biografive të autorëve madhorë të kësaj letërsie;
- të jetë në gjendje ti aplikojë ato njohuri në aktivitetet e tij profesionale (si mësimdhënës, kritik letrar, hulumtues shkencor etj.)
- të jetë në gjendje t'i aplikojë ato njohuri në aktivitetet e tij profesionale (si mësimdhënës, kritik letrar, hulumtues etj.)

### **Plani i detajizuar i mësimi:**

*Java e parë:* Historia e frankofonisë dhe institucionet aktuale të frankofonisë

*Java e dytë:* Gjeografia e letërsive frankofone

*Java e tretë:* Letërsia belge

*Java e katërt:* Letërsia e Zvicrës romane

*Java e pestë:* Letërsia e Kebekut dhe e Kanadasë frënge

*Java e gjashtë:* Letërsia frankofone algjeriane

*Java e shtatë:* Letërsia frankofone marokene

*Java e tetë: Vlerësimi i parë intermediar*

*Java e nëntë:* Letërsia frankofone tuniziane

*Java e dhjetë:* Letërsia frankofone e Afrikës subsahariane

*Java e njëmbëdhjetë:* Letërsia frankofone e Madagaskarit

*Java e dymbëdhjetë:* Letërsia frankofone e ishujve kreol

*Java e trembëdhjetë:* Letërsia frankofone e Lindjes së afërt – Libani dhe Egjipti

*Java e katërmëdhjetë:* Letërsia frankofone e Evropës lindore

*Java e pesëmbëdhjetë: Vlerësimi i dytë intermediar*

### **Format/ Metodatat e mësimdhënies:**

*Mësimi organizohet në formë ligjëratae dy orë në javë. Puna në grupe konsiston në studimin e teksteve të autorëve kryesor.*

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

<b>Pjesa teorike</b>	<b>Pjesa praktike</b>
75%	25%

### **Metodat e vlerësimit:**

Vlerësimi i parë: 20%

Vlerësimi i dytë: 20%

Vijimi i rregullt :10%

Provimi final: 50%

Total: 100%

### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Studenti dhe profesori duhet të respektojnë Rregulloren e mirësjelljes e miratuar nga Fakulteti i Filologjisë.

### **Literatura shtesë dhe bibliografia:**

Denise BRAHIMI, *Langue et littératures francophones*, Ellipses, Paris, 2001

Christiane NDIAYE (sous la direction de), *Introduction aux littératures francophones*, Les Presses de l'Université de Montréal, Montréal, 2004.